



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

• Konstruksiione

• Hidroteknikë

• Gjeodezi

• Inxhinieri e Ambientit



RRETH NESH!

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit është njësi Akademike e Universitetit të Prishtinës dhe trashëgon një histori të saj të numëruar në dekadën e shatë dhe njihet si institucioni fillestar i shkencave teknike në vendin tonë, i themeluar në vitin 1961.

Janë shumë shërbime të cilat Inxhinierët janë në gjendje të ofrojnë për tregun e punës sikur, projektimi i strukturave, projektimi i sistemeve dhe impianteve ujore, shërbime gjeodezike, vlerësime të ndryshme të projekteve dhe objekteve si dhe shumë punë të tjera që lidhen me profesionin sikur janë konsultatat, vlerësimet e shpejta, identifikimi i rreziqeve nga fenomenet natyrore. Shumë nga kuadrat tona janë pjesë e kompanive me renome në rajon dhe Botë si dhe institucione, përkatesisht Universitete të njohura arsimore

Oferta përmes Programeve të studimit Bachelor dhe Master:

- Konstruksione
- Hidroteknike
- Gjeodezi
- Inxhinieri e ambientit

Pa inxhinierët e Ndërtimit (Konstruktiv, Hidroteknikë, Gjeodezi, Inxhinieri e Ambientit) dhe veprat e tyre, njerëzimi do ta kishte jetën më të vështirë. Duke ndërtuar rrugë që kalojnë pengesa natyrore, rrjedha të lumenjve, penda ujore, objekte për nevoja të njerëzimit - Stadiume, Salla sportive, Objekte të kulturës, lidhje GPS, GPRS dhe të tjera njerëzimit i bëhet jeta më e lehtë, duke u zhvilluar më shpejt në kohë, duke plotësuar nevojat e veta për një jetë të përsosur.

Zhvillimi i programeve të studimeve është i bazuar në kërkesat e tregut të punës. Pas përfundimit të studimeve hapen rrugët për punësime në tregun e punës në vend dhe jashtë vendit, si dhe mundësia e madhe e vazhdimit të mëtejshëm të studimeve shkencore dhe profesionale.

Kontakti Adresa: Rr. "Agim Ramadani",
Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, p.n. 10
000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Telefoni: +383(0)38 554 899 ext.103

Email: fin@uni-pr.edu

Web: <https://fin.uni-pr.edu/>

Pse unë duhet të studioj inxhinierinë e ndërtimit pranë fakultetit të ndërtimtarisë?

Fushat e Inxhinierisë së ndërtimit formësojnë Botën ku ne jetojmë. Njohuritë e disiplinave shkencore inxhinierike na shërbejnë për jetë më të mirë, më të lehtë dhe më të këndshme.

Prandaj, për të studiuar te NE, ju do të jeni më afër realitetit Dinamik të jetës, do të njiheni me materialet e ndërtimit, llojet e objekteve, shërbimeve të shpejta gjeodezike, hidrologjinë, hidroteknikën, ambientin duke vlerësuar ligjet natyrore të fizikës.





Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit ju ofron:

- Ambiente të përshtatshme, atraktive dhe komode për të studiuar
- Laboratorët e materialeve ndërtimore, asfaltit, gjeomekanikës, hidroteknikës, gjeodezisë dhe Inxhinierisë së mjedisit
- Zhvillime bashkëkohore dhe moderne të mësimdhënies duke krijuar lehtësi për mësimnxënie cilësore dhe të shpejt.

Programi i studimeve për Konstruksione do të ju jep njohuri dhe ju përgatitë që pas përfundimit të studimeve ju do të jeni në gjendje të projektoni dhe llogarisni Struktura të objekteve ndërtimore, të njiheni me materialet e ndërtimit, të shfrytëzoni softwerët profesional AutoCAD, Sofistik, Robotmilenium, Etabs etj.



Në kuadër të këtij programi zhvillohen programet e studimeve në nivelin Baçelor (3 vjeçare) dhe Master Shkencorë për konstruksione (2 vjeçare), të cilat janë koherente mes vete dhe me kurrikulë të ndërtuar për fitimin e njohurive nga më të thjeshtat deri te ato më të avansuara.

Stafi akademik është me përkushtim në mësimdhënie dhe jo vetëm, ai angazhohet edhe në aktivitete tjera sikur janë shërbimet për Fakultetin, hulumtimet shkencore, shërbimet institucioneve vendore si dhe aktivitete tjera sociale, organizim të vizitave studimore në vendet e rajonit si dhe në Europë.

Studentët nga ky program i studimeve mund të përfitojnë edhe bursa për studime në universitete të njohura jashtë vendit, përmes programeve ERASMUS+.

Programi i studimeve për Hidroteknikë do të ju jep njohuri dhe të ju përgadit që pas përfundimit të studimeve të jeni në gjendje të bëni vlerësimin e burimeve ujore, projektimin e instalimeve hidrosanitare, projektimin e veprave hidroteknike, trajtimin e ujit të pijës dhe ujit të ndotur, projektimin e sistemeve të kullimit dhe ujitjes së tokës si dhe aplikimin e softwerëve profesional në fusha të ndryshme të Hidroteknikës.

Në kuadër të këtij programi zhvillohen programet e studimeve në nivelin Baçelor (3 vjeçare) dhe Master Shkencorë (2 vjeçare), të cilat janë koherente mes vete dhe me kurrikulë të ndërtuar për fitimin e njohurive nga më të thjeshtat deri te ato më të përbëra.

Studentët e këtij drejtimi kanë mundësinë të kryejnë punë praktike në të gjitha institucionet shtetërore me të cilat Fakulteti ka memorandume bashkëpunimi. Programi mundëson studime për një semestër apo vazhdim studimesh edhe jashtë Fakultetit të Ndërtimtarisë në Universitete Ndërkombëtare. Disa nga mundësitë e tilla rezultojnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit midis Fakultetit të Ndërtimtarisë me Universitete të tjera Ndërkombëtare, si “Universita degli Studi di Trento” në Itali. Nga ky drejtim shumë student kanë përfituar edhe bursa për studime në Universitete të njohura jashtë vendit, përmes programeve ERASMUS+.



Për detaje më të hollësishme shih vegzën:
<https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,56>

Gjithashtu, programi ofron shumë aktivitete, të cilët studentët mund t'i shfrytëzojnë gjatë semestrit veror, dimëror, por edhe gjatë pushimeve. Ata mund të bëhen pjesë e konferencave, trajnimeve, punëtorive të ndryshme, debateve me tema studentore dhe shumë aktivitete të tjera. Në kuadër të programit organizohen edhe vizita studimore të fushës së Hidroteknikës, me qëllim studimi dhe avancimi profesional të studentëve.

Të diplomuarit në drejtimin Hidroteknikë mund të kërkojnë një shumëllojshmëri të gjerë mundësish punësimi në Institucione Shtetërore si në Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Agjensionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Kompani të ndryshme Private si dhe në shumë fusha tjera që lidhen me Hidroteknikë.

Për detaje më të hollësishme rreth Programit Studimor Hidroteknikë shihni vegzën:

<https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,32>

Programi i studimeve për Gjeodezi dhe

Gjeoinformatikë është hartuar duke vlerësuar trendet e zhvillimit në vend, si dhe në nivel ndërkombëtar të fushave të gjeoinformatikës, kadastrit, inxhinierisë së ndërtimit, hartografisë dhe shkencave të gjeoinformacionit në përgjithësi. Ky program i studimeve ofrohet për nxënësit të cilët përfundojnë shkollën e mesme, dhe studimet në këtë program zgjasin 3 vite.





Mësimdhënia në këtë program ofrohet nga staf akademik me përvojë të gjatë, dhe të cilët përdorin metodat më bashkëkohore në mësimdhënie, ku **STUDENTI** është në qendër. Gjatë mësimnxënies studentët do të mund të përdorin pajisjet nga zhvillimet më të fundit teknologjike, si:

- Pajisje më të reja për matjen e tokës (GPS, TPS, Skaner 3D laserik, dhe Droni për fotografim ajror).
- Softuerë për përpunim, ruajtje, analizë dhe administrim të të dhënave hapësinore, si dhe krijimin e hartave.

Studentët mund të bëhen pjesë e konferencave, trajnimeve apo punëtorive të ndryshme, si dhe të marrin pjesë në vizita studimore në institucione përkatëse. Për më tepër, studentët kanë mundësi të bëjnë punë praktike në institucionet shtetërore të fushës, si dhe në organizata apo institucione të tjera private. Në kuadër të mobilitetit mundësohen studime për një semestër në Universitete të ndryshme Ndërkombëtare.

Studentët do të jenë në gjendje të marrin njohuritë e nevojshme dhe të aftësohen për zgjidhjen e problemeve kadastrale (pronësore), inxhinierisë së ndërtimit, dhe administrimit të tokës si tërësi.

Të diplomuarit do të kenë njohuri dhe aftësi të shkëlqyeshme, të cilat do t'i mundësojë punësim të menjëhershëm në tregun e punës. Gjithashtu, të diplomuarit do ta kenë mundësinë e vazhimit të studimeve të avancuara në nivel Master në Gjeodezi dhe Gjeoinformatikë.

Për të tjera mund të informoheni në

<https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,31>

<https://www.facebook.com/Departamenti-i-gjeodezis%C3%AB-108526990798227>

Programi i studimeve Inxhinieri e Ambientit

Inxhinieria e Ambientit investon në karrierën dhe ardhmërinë tuaj, duke konsideruar se zhvillimi juaj profesional është prioriteti ynë.

Inxhinieria dhe Ambienti nuk janë kundër njëra tjetrës, por ato bashkë ofrojnë zgjidhje. Kurrikula e Inxhinierisë së Ambientit ofron një përmbajtje multidisiplinare. Ajo, kombinon lëndë të inxhinierisë së ndërtimit, lëndë ambientale, lëndë të ekonomisë, informatikës, etj., duke kontribuar bashkë, si një, në një ambient të qëndrueshëm.

Mësimdhënësit e kualifikuar dhe me fushë interesi çështjet që lidhen me ambientin, ofrojnë jo vetëm mësimdhënie e hulumtime, por në klasë sjellin edhe njohuri aktuale nga fushat profesionale që lidhen me ambientin.

Studentët e Inxhinierisë së Ambientit për përfitim profesional dhe hulumtues zhvillojnë punën praktike, në institucione, kompani dhe /apo organizata profesionale, relevante me fushën e Inxhinierisë së Ambientit me të cilat Fakulteti i Ndërtimitarisë ka marrëveshje bashkëpunimi. Shembuj të vetëm disa institucioneve, kompanive e organizatave ku studentë të Inxhinierisë së Ambientit tani më kanë përfunduar punën praktike janë: Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës; Kompani Rajonale Ujësjiellësi; Institutin “INKOS” etj.

Studentët e drejtimit Inxhinieri e Ambientit kanë krijuar projektin “**Te Pema**”, që është cilësuar si inovacion shumë i rëndësishëm për pastrimin e ajrit në Prishtinë.



Inxhinieria e Ambientit ka përgatitur studentë nga të cilët disa sot veç kanë përfunduar studimet master e disa edhe kanë vazhduar studimet e doktoratës. Programi IA, duke ofruar një kurrikulë të krahasueshme me kurrikula ndërkombëtare (e vlerësuar nga ekspertë ndërkombëtarë) mundëson studime për një semestër apo vazhdim studimesh edhe jashtë Fakultetit të Ndërtimitarisë apo edhe në Universitete ndërkombëtare. Disa nga mundësitë e tilla rezultojnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit midis Universitetit të Prishtinës (FN-së, programit Inxhinieri e Ambientit) me Universitete të tjera ndërkombëtare, si:

Universita degli Studi di Trento/Itali
Poznan University/ Poloni, etj.

Për detaje më të hollësishme shih vegzën:

<https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,56>

Të diplomuarit në Inxhinieri Ambienti shfrytëzojnë logjikën dhe arsyen për të identifikuar të mirat dhe dobësitë e zgjidhjeve të mundshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujit urban, mbrojtjen e ujit nga ndotja, riciklimin dhe menaxhimin e mbeturinave, kontrollin e ndotjes së ajrit, etj. Inxhinierët e Ambientit, do të jenë të përgatitur për të ndjekur një gamë të gjerë mundësish punësimi në këtë fushë në rritje dhe në zhvillim, duke përfshirë zyra dizajni, inxhinierike, konsulence, në industri, në shoqatë, në sektor publik, në agrikulturë, në urbanizëm, në bashkëpunim me të tjerët për të siguruar ndryshim dhe zhvillim të ideve të reja.

Nevoja e inxhinierëve të ambientit në Kosovë është e pashmangshme, andaj ejani dhe ndihmoni vendin tuaj për një zhvillim ambiental të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm për gjeneratat e reja.

Për detaje më të hollësishme rreth Programit Studimor Inxhinieri Ambienti shihni vegzën:

<https://fn.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,67>.

Ne, me punën tonë Institucionale, ju ofrojmë jetë sociale të lidhur me realitetin, aktivitete të zhvillimit të njohurive në terrene në vend dhe jashtë vendit, shërbime të shpejta administrative si dhe hapje e mundësive të reja për avancime shkencore dhe profesionale.

Sta fijenë akademik numëron emra me potencial shkencorë, të cilë të rinjë në moshë ishin studentët tanë që tashmë janë në vazhdim të arritjeve të karrierës dhe me kontributin e tyre janë promovues të rritjes së cilësisë në Institucionin tonë.

Kujdestar të cilësisë do të jemi gjithmonë NE, që dija juaj të jetë e vlerësuar drejt, arritjet e juaja të shtyhen në zhvillime reale, diploma e juaj të njihet ndërkombëtarisht.

Le të ndërtojmë të ardhmen !

